



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi-Skupština-Assembly*

---

**Legjislatura e V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**RAPORT PËR MBIKËQYRJE**

**Zbatimi i nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës**

**Prishtinë, dhjetor 2016**

<b>I. Hyrje.....</b>	<b>5</b>
<b>II. Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit .....</b>	<b>5</b>
<b>III. Metodologjia .....</b>	<b>6</b>
<b>IV. Përbërja e grupit punues.....</b>	<b>6</b>
<b>V. Aktivitetet e grupit të punës .....</b>	<b>7</b>
<b>A. Mbledhjet e grupit të punës dhe suaza ligjore.....</b>	<b>7</b>
<b>B. Dëgjim publik dhe raportimet e ministrave dhe autoriteteve tjera .....</b>	<b>8</b>
<b>C. Pjesëmarrja e Shoqërisë civile .....</b>	<b>8</b>
<b>VI. Raportimi në mbledhjen e Komisionit për aktivitetet e planifikuara dhe të     ndërmarra .....</b>	<b>9</b>
<b>VII. Zbatimi i nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës     .....</b>	<b>9</b>
<b>Të gjeturat.....</b>	<b>9</b>
<b>VIII. Përfundim .....</b>	<b>19</b>
<b>IX. Rekomandime .....</b>	<b>19</b>
<b>X. Materialet përcjellëse.....</b>	<b>21</b>

## *Lista e Shkurtesave*

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	KDIKK
Grupi punues	GP
Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës	LSHC
Zyra e Kryeministrit	ZKM
Zyra Qeveritare për Çështje të Komuniteteve	ZQÇK
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	MMPH
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	MTI
Ministria e Shëndetësisë	MSH
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	MKRS
Ministria për Komunitete dhe Kthim	MKK
Ministria e Infrastrukturës	MI
Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale	MPMS
Ministria e Administratës Publike	MAP
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	MASHT
Ministria e Financave	MF
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	MBPZHR
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	MZHE
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	MAPL
Ministria për Komunitete dhe Kthim	MKK
Ministria e Punëve të Jashtme	MPJ
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria e Forcës së Sigurisë	MFS
Ministria e Punëve të Brendshme	MPB
Ministria e Diasporës të Kosovës	MDK
Ministria për Integritet Evropian	MIE
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	ZPRK
Kuvendi i Republikës së Kosovës	KRK
Policia e Kosovës	PL
Shërbimi Doganor	SHD
Komisioni Qendror Zgjedhor	KQZ
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës	ZAPK
Institucioni i Avokatit të Popullit	IAP
Instituti Demokratik i Kosovës	KDI
Universiteti i Prishtinës	UP
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	GJKK
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	KGJK
Instituti Gjyqësor i Kosovës	IGJK

Këshilli Prokurorial i Kosovës	KPK
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil	KPMSHC
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë	KKTK
Komisioni i Pavarur për Media	KPM
Komisioni i Pavarur për Miniera të Kosovës	KPMK
Njësia e Inteligjencës Financiare	NJIK
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	KRRPP
Organi Shqyrtues i Prokurimit	OSHP
Agjencia për Ndihme Juridike Falas	KNJF
Agjencia Kundër Korrupsion	AKK
Agjencioni Kosovar i Pronës	AKP
Agjencia e Aviacionit Civil	AAC
Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës	ASHAK
Agjencia Kosovare e Konkurrencës	AKK
Agjencia Shtetërore e të Dhënave Personale	ASHDHP
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	ARKEP
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	ARRH
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	PZAP
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina	ZRRUM
Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	AMKM
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian	OSBE

## **I. Hyrje**

Duke u bazuar në rregullin 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka kompetencë që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit në kuadër të fushë veprimtarisë së punës së tij. Për zbatimin e këtyre kompetencave, Komisioni ka bërë kontrollimin për efikasitetin e Ligjit që është në fuqi, paraqet propozime për masat konkrete të cilat duhet të ndërmarrën, bënë kontrollimin e punës së ministrive përkatëse për zbatimin e Ligjit dhe raporton Kuvendin për nivelin e zbatimi të Ligjit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në kuadër të përgjegjësiive për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit, planin e punës për vitin 2016. ka vendosur që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me qëllim të përcaktimit të shkallës së zbatimit të këtij neni në praktikë përkitazi me çështjen e pranimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civilë.

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i gjendjes momentale mbi përfaqësimin e komuniteteve në shërbimet e administratës publike dhe që institucioneve relevante t’iu paraqesë argumente për çështjen e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve në sektorin publik në nivelin qendror dhe lokal.

Raporti analizon të dhënat statistikore në krahasim me kushtet ligjore në mënyrë që të përcaktohet se a është duke u zbatuar parimi ligjor nga ana e institucioneve të pushtetit, të paraqes konstatime dhe përfundime të rëndësishme, të paraqet disa rekomandime institucioneve kompetente me qëllim të marrjes së masave pozitive për ngritjen e shkallës së punësimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimet e administratës publike.

## **II. Qëllimi i mbikëqyrjes**

Qëllimi kryesorë i mbikëqyrjes për zbatimin e nenit 11, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është që të vlerësohet niveli i zbatimit në praktikë i këtij ligji dhe të grumbullohen të dhëna të mjaftueshme lidhur me problemet e zbatimit, duke u bazuar në të dhënat e institucioneve relevante të përfituara nga dëgjimi publik, hulumtimet parlamentare të mundësuar me mbështetje të USAID-it, për projektin e realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës për nevoja të Kuvendit të Kosovës, si dhe të vlerësohet sa i plotëson Qeveria obligimet të cilat dalin nga ky ligj.

### **III. Metodologjia**

Mbikëqyrja e zbatimit të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është bërë në disa faza:

Në fazën e parë, janë kërkuar informacione zyrtare nga ana e Zyrës juridike e Qeverisë dhe Ministria e Administratës Publike përkitazi me problematikën e zbatimit të legjislacionit relevant për punësimin e komuniteteve jo shumicë në Administratën Publike në Kosovë.

Në fazën e dytë të këtij procesi, Komisioni nga KDI-a ka kërkuar hulumtim parlamentar në temën: “Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror të Kosovës” me qëllim që të vlerësojë gjendjen aktuale të përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimet shtetërore me qëllim të zbatimit të politikave të cilat e rregullojnë përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në institucione të nivelit qendror dhe lokal dhe se a ekziston përfaqësimi adekuat.

Në fazën e tretë, Komisioni ka organizuar një dëgjim publik të mbikëqyrjes si dhe ka ftuar në raportim ministrin e MAP dhe organe tjera qeveritare për të marrë informacione, njoftime lidhur me problemin që ka të bëjë me zbatimin në praktikë të ligjit dhe të çështjeve të tjera të cilat kanë të bëjnë me implementimin e Ligjit me interes publik.

Në fazën e katërt të punës, ka hartuar raportin përfundimtar të cilin ia ka paraqitur Komisionit për ta shqyrtuar dhe miratuar.

### **IV. Përbërja e grupit të punës**

Komisioni në bazë të kompetencave të sajë ka vendosur që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit dhe për këtë qëllim ka formuar GP (në tekstin e mëtejme Grupin Punues) i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit me këtë përbërje:

1. Veton Berisha (Grupi Parlamentar i LDK-së), kryetar
2. Çerim Bajrami (Grupi Parlamentar i 6+), anëtarë
3. Milka Vuletić (Grupi Parlamentar i LS-së), anëtarë
4. Kimete Bytyqi (Grupi Parlamentar i LDK-së) anëtarë
5. Mufera Sinik (Grupi Parlamentar i 6+), anëtarë

GP në të gjitha fazat e përcjelljes për zbatimin e Ligjit ka qenë i mbështetur nga stafi për përcjelljen e punës së komisionit dhe partneri i OSBE-së. Mbështetja e tyre ka qenë profesionale – teknike dhe logjistike.

## **V. Aktivitetet e grupit punues**

GP aktivitetet e veta gjatë këtij procesi të kontrollimit i ka zhvilluar në bazë të autorizimeve që ka nga Komisioni, Plani i punës dhe Plani i veprimit për mbikëqyrjen e LSHC në bazë të të cilave ka bazuar aktivitetet e veta në pikëpamje të mbajtjes së mbledhjeve, organizimit të dëgjimeve publike dhe hartimit të raportit përfundimtar së bashku me gjetjet dhe rekomandimet.

Pas përfundimit të aktiviteteve të planifikuara, GP ka hartuar raportin përfundimtar për mbikëqyrjet, të cilin e ka paraqitur për shqyrtim në Komision.

### **A. Mbledhjet e grupit punues dhe suaza ligjore**

GP ka mbajtur 4 mbledhje, me qëllim të planifikimit dhe të koordinimit të aktiviteteve të saja dhe ka analizuar këto ligje dhe dokumente:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
- Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
- Ligji kundër diskriminimit 2004/3 /19.02.2004
- Rregullore nr.04/2010 për veprimet e drejta dhe përfaqësimin proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin publik të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim të trajtimit të kësaj çështjeje ka kërkuar informacione zyrtare dhe interpretime autentike nga institucionet relevante siç janë:

1. Ministria e Administratës Publike:  
Pyetëtori me pasqyrën e përfaqësimit të Komuniteteve jo shumicë në nivelin qendror dhe lokal në organet e Administratës Publike, Agjencitë e pavarura dhe organet tjera të pushtetit ekzekutiv, nga muaji mars 2015 për të gjithë të punësuarit në nivelin qendror dhe nga muaji maj 2015 pasqyrën e të punësuarve në pozicione funksionale.
2. Zyra juridike e Qeverisë së Republikës së Kosovës:  
Kërkesa për interpretimin juridik të nenit 11.2 dhe 3 të Ligjit mbi shërbimin civil të Republikës së Kosovës për parimet e drejta ligjore dhe përfaqësimit proporcional të komuniteteve jo shumicë në organet e administratës publike.
3. Kërkesa e KDI-së për hulumtim parlamentar në temën: “Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në administratën shtetërore të Kosovës”.

Pas marrjes së përgjigjeve me shkrim, raporteve dhe prezantimit të hulumtimeve parlamentare nga institucionet e theksuara, GP i ka shqyrtuar të njëjtat, ku janë identifikuar mungesa dhe përparësi në zbatimin e ligjit.

### **B. Dëgjim publik dhe raportimet e ministrave dhe autoriteteve tjera**

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes për zbatimin e nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civilë të Republikës së Kosovës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka organizuar dy debate publike më 09.10.2015 dhe 20.06.2016 me këto institucione:

- Ministrinë e Administratës Publike
- Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministrinë pa Portofol
- Zyrën për Çështjen e Komuniteteve në Kabinetin e Kryeministrit
- Këshillin Konsultativ të Komuniteteve
- Zyrën juridike në Kabinetin e Kryeministrit
- Këshillin e Pavarur mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës
- Institutin Demokratik të Kosovës
- Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
- Asociacionin e Komunave të Kosovës
- Organizatat jo qeveritare: “Ideja e partneritetit”
- Ambasadat: SHBA, Zvicra, Gjermania, Finlanda Norvegjia dhe Suedia.

Komisioni më 08.12.2015 dhe 13.07.2016 ka ftuar për të raportuar Ministrin e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) Këshillin e Shërbimit të Pavarur Mbikëqyrës i Republikës së Kosovës (KSHPMRK) me qëllim të marrjes së informacioneve dhe shënimeve të nevojshme zyrtare për zbatimin e Ligjit, posaçërisht të nenit 11 Lidhur me çështjet e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civilë të Kosovës.

### **C. Pjesëmarrja e shoqërisë civile**

Procesin e mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit e kanë përcjellë përfaqësuesit e shërbimit civilë në të gjitha fazat e monitorimit nga fusha e këndë-veprimit të tyre si dhe palët e interesuara, me rastin e mbajtjes së debateve publike, prezantimeve të hulumtimeve parlamentare të KDI-së, raportimin e ministrave dhe autoriteteve tjera, duke realizuar bashkëpunim institucional, pa pjesëmarrjen në debate apo të dhënies së iniciativave.



## **VI. Raportimi në mbledhjen e Komisionit për aktivitetet e ndërmarra dhe të planifikuara**

Raportuesi i GP Veton Berisha, në mbledhjen e Komisionit të mbajtur më 23.12.2016 ka paraqitur raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civilë të Republikës së Kosovës, lidhur me aktivitetet, konstatimet e institucioneve relevante dhe gjendjen në teren. Në këtë mbledhje është miratuar raporti me rekomandimet për nivelin e zbatimit të ligjit me rekomandim për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

## **VII. Zbatimi i nenit 11 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë i Republikës së Kosovës**

### **Të gjeturat:**

Në bazë të drejtimit me shkrim institucioneve për hulumtime parlamentare, debateve të mbajtura publike dhe të raportimit të ministrave dhe autoriteteve tjera, GP ka grumbulluar këto të gjetura:

- 1. Moszbatimi i dispozitës së nenit 61.1, nenit 101 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 i Ligjit për Shërbimin Civilë dhe Rregullorës nr .04/2010 për të drejtat dhe veprimet në mënyrë të drejtë dhe proporcionale të përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

### **1.1 Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në nivelin qendror**

Në bazë të të dhënave preliminare dhe statistikave zyrtare të cilat i ka grumbulluar MAP për vitin 2015, numri i nënpunësve civil të punësuar në 51 institucione qendrore të Shërbimit Civil arrin në 12,367%. çka do të thotë se përqindja e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, ëshë nën nivelin e shkallës prej 3,76%, nga pragut i përcaktuar ligjor, prej 10%.

Nga numri i përgjithshëm i nënpunësve civil të punësuar në nivelin qendror në Shërbimin Civil janë: shqiptar 11,595 apo 93.76%; serb 455, apo 3.67%; boshnjak 129, apo 1.04%; turq 134, apo 1.08%; goran 18, apo 0.14%; ashkali 9, apo 0.07; egjiptian 4, apo 0.03%; rom 17, apo 0.13%; të tjer 6, apo 0.04%.

***Tabela 1: Pasqyron numrin dhe përqindjen e nënpunësve civil të të gjitha komuniteteve të punësuar në 51 institucione të nivelit qendror.***

Nr.	Institucio net e nivelit qendror	Nr. i përgjit hshëm	Shqiptar	Serbë	Bosh njak	Turq	Gor an	Ash kali	Egji ptia n	Rom	Tjer ë
1.	ZKM	531	498	13	8	9	2	1	0	0	0
2.	MMPH	267	260	-	3	4	-	-	-	-	-
3.	MTI	182	179	-	2	-	-	-	1	-	-
4.	MSH	662	646	-	1	15	-	-	-	-	-
5.	MKRS	377	361	3	3	6	1	1	2	-	-
6.	MI	241	232	2	2	4	1	-	-	-	-
7.	MPMS	889	797	72	13	6	-	-	-	1	-
8.	MAP	254	231	14	-	7	-	1	-	-	1
9.	MASHT	620		3	13	6	-	-	-	3	1
10.	MF	1015	984	19	6	4	1	-	-	1	-
11.	MBPZHR	302	291	6	5	-	-	-	-	-	-
12.	MZHE	120	117	-	-	3	-	-	-	-	-
13.	MAPL	116	103	10	1	2	-	-	-	-	-
14.	MKK	81	44	32	1	3	1	-	-	-	-
15.	MPJ	232	225	1	2	3	1	-	-	-	-
16.	MD	401	387	7	4	2	-	1	-	-	-
17.	MFS	215	210	-	4	1	-	-	-	-	-
18.	MPM	1062	1017	26	6	8	2	3	-	-	-
19.	MDK	46	42	-	2	2	-	-	-	-	-
20.	MIE	64	64	-	-	-	-	-	-	-	-
21.	ZPRK	43	39	-	2	1	1	-	-	-	-

22.	KRK	172	156	8	2	6	-	-	-	-	-
23.	PK	1117	992	96	14	8	4	-	-	1	2
24.	SHD	72	71	-	-	1	-	-	-	-	-
25.	KQZ	72	62	9	-	1	-	-	-	-	-
26.	ZAPK	149	143	5	1	-	-	-	-	-	-
27.	IAP	48	43	3	-	-	-	1	-	-	1
28.	UP	398	398	-	-	-	-	-	-	-	-
29.	GJJK	41	37	1	1	1	-	-	-	-	1
30.	KGJK	1494	1337	106	20	18	3	1	-	9	-
31.	IGJK	26	26	-	-	-	-	-	-	-	-
32.	KPK	433	414	4	8	5	1	-	-	1	-
33.	KPMSHC	18	16	-	1	1	-	-	-	-	-
34.	KKTK	7	7	-	-	-	-	-	-	-	-
35.	KPM	31	29	-	1	1	-	-	-	-	-
36.	KPMK	69	67	1	-	1	-	-	-	-	-
37.	NJIF	18	18	-	-	-	-	-	-	-	-
38.	KRRPP	25	25	-	-	-	-	-	-	-	-
39.	OSHP	17	17	-	-	-	-	-	-	-	-
40.	ANJF	22	19	-	1	1	-	-	1	-	-
41.	AKK	40	39	-	-	1	-	-	-	-	-
42.	AKP	223	204	14	1	3	-	-	-	1	-
43.	AAC	26	26	-	-	-	-	-	-	-	-
44.	ASHAK	18	18	-	-	-	-	-	-	-	-
45.	AKKK	12	12	-	-	-	-	-	-	-	-
46.	ASHMD HP	17	17	-	-	-	-	-	-	-	-


47.	ARKEP	30	30	-	-	-	-	-	-	-	-
48.	ARRH	17	17	-	-	-	-	-	-	-	-
49.	PZAP	10	9	-	1	-	-	-	-	-	-
50.	ZRRUM	17	17	-	-	-	-	-	-	-	-
51.	AMKM	8	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>12367</b>	<b>11595</b>	<b>455</b>	<b>129</b>	<b>134</b>	<b>18</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>17</b>	<b>6</b>
<b>PERQINDJA</b>		<b>100%</b>	<b>93.76</b>	<b>3.67</b>	<b>1.04</b>	<b>1.08</b>	<b>0.14</b>	<b>0.07</b>	<b>0.03</b>	<b>0.13</b>	<b>0.04</b>

Nga statistikat e prezantuara dhe analiza e kryera del se nga numri i përgjithshëm prej 51 institucioneve, për sa kanë raportuar numrin e të punësuarëve, 15 institucione në nivel qendror nuk kanë të punësuar asnjë pjesëtar të komuniteteve joshumicë, ndërsa një numër prej 6 institucioneve kanë të punësuar vetëm nga 1 apo 2 pjesëtar të komuniteteve shumicë. Pothuaj të gjitha ministritë dhe agjencitë ekzekutive janë me përfaqësim nën 10% të komuniteteve joshumicë. Nga të gjitha institucionet një numër krejtësisht i vogël i institucioneve qendrore, ka arritur pragun e kërkuar ligjor të përfaqësimit të drejt dhe proporcional prej 10%: KGJK; GJKK; PK,MPMS.


Si përfundimë, nëse nisemi nga sqarimet dhe rëndësia e nenit 11, të LSHP-së dhe kuotës së përcaktuar prej 10% në raport me përbërjen e popullsisë, Komunitetet jo shumicë Egjiptasit, Romët, Ashkalitë dhe Goranët edhe më tutje nuk janë të përfaqësuar në masën e duhur.

***Figura 1: Pasqyron përqindjen e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve në nivelin qendror në Shërbimin Civil.***

Nga numëri i përgjithshëm prej 12,367, janë: shqiptar 11,595, apo 93.76%; serb 455, apo 3.67%; boshnjak 129, apo 1.043%; turq 134, apo 1.084%; goran 18, apo 0.146%; ashkali 9, apo 0.037%; egjiptian 4, apo 0.032%; rom 17, apo 0.137%; të tjer 6, apo 0.049%.




***Tabela 2: Pasqyron numrin dhe përqindjen e përfaqësimit në nivel qendror të komuniteteve joshumicë, përkundrejt numrit të përgjithshëm prej 12.367 nëpunës civil.***



Kështu që mund të përfundojmë, nëse nisemi nga sqarimet dhe rëndësia e nenit 11 të LSHP, dhe kuotës së përcaktuar prej 10% në raport me përbërjen e popullsisë, Komunitetet joshumicë Ashkali, Romë, Egjiptian dhe Goran, nuk janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme.

**Tabela 3: Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit në nivelin qendror të komuniteteve joshumicë, përkundrejt përqindjes së popullsisë.**



## 1.2 Përfaqësimi i komuniteteve në nivelin lokal

### 1.2. Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në nivelin lokal

Siç është theksuar më parë, me qëllim të zbatimit të nenit 11, të LSHC-së dh Rregullorës nr. 04/2010, për veprimet e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, komunat janë të detyruara të sigurojnë një shërbim civil i cili përfaqëson përbërjen etnike të banorëve të tyre.

Duke u nisur nga numri i raportit të të punësuarve në nivel të pushtetit lokal, pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë në qeverinë lokale, arrin përqindjen në 16.83%.


Në nivel të pushtetit komunal, përfshirë këtu 38 komuna, janë të punësuar gjithsejtë 6,679 nëpunës civil. Nga ky numër shqiptar janë 5,556 (83.17%); serb 855 (12.8%); boshnjak 130 (1.94%); turq 80 (1.2%) ; goran 7 (0.10%); Ashkali 21 (0.30%); egjiptas 8 (0.12%); rom 16 (0.24%) dhe të tjerë 6 (0.09)<sup>20</sup>.

**Tabela 4: Pasqyra me numrin dhe përqindjen e nënpunësve civil të komuniteteve të punësuar në 38 komuna të Kosovës.**


Nr .	komuna	Nr. i përgjithshëm	Shqipëtar	Serbë	Bosnjakë	Turq	Goran	Ashkali	Egjiptian	Rom	Të tjerë
1	Deqan	137	134	1	2						
2	Dragash	138	100		38						
3	Ferizaj	251	235	1		1	2	9		3	
4	Fushe-Kosove	148	126	17				3		2	
5	Glllogovc	162	162								
6	Gjakove	212	208								4
7	Gjilan	342	301	37		3				1	
8	Istog	177	161	2	9				5		
9	Kaçanik	138	146	3							2
10	Kamenice	188	153	35							
11	Kline	151	130	3						1	
12	Lypjan	153	138	10	1	1		2		1	
13	Malisheve	177	177								
14	Mitrovica J.	372	354	2	9	5		1		1	
15	Mitrovica. V	58	10	37	6	4	1	1			
16	Novobërdë	84	48	34						2	
17	Obiliq	126	112	11	2	3				1	
18	Peje	335	315	2	13	29	2		2	1	
19	Podujeve	236	233	2				1			
20	Prishtine	635	627	2	2	3		1			
21	Prizren	463	385	2	42	26	2	1	1	1	
22	Rahovec	174	163	11							
23	Skenderaj	200	191	9							
24	Suhareke	211	174					2			
25	Shtërpce	107	37	70							
26	Shtime	99	97		1		1				
27	Viti	200	197	3							
28	Vushtrri	247	232	12		3		1			
29	Hani Elezit	55	54		1						
30	Mamushë	41	7		1	31				2	
31	Juniku	50	50								
32	Kllokot	50	50	16	34						
33	Partesh	37	2	35							
34	Ranillugë	57	6	51						1	
35	Graçanice	58	4	51			2			1	
36	Leposaviq	127	8	116	3						
37	Zubin Potok	226	16	210							
38	Zveqan	57	4	53							

	Totali	6.679	5.556	855	130	80	7	21	8	16	6
	%	100%	83.17	12.8	1.94	1.2	0.10	0.30	0.12	0.24	0.09

**Figura 2: Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të komuniteteve në nivel të pushtetit komunal.**



**Tabela 5: Pasqyra e përqindjes së përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në nivel të pushtetit komunal.**




Sipas statistikave zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, nga numri i përgjithshëm i popullsisë prej 1,739,825, janë: shqiptar 1,616,869 (92.9%); serbë 25,532 (1.5%); turk 18,738 (1.1%); boshnjak 27,533 (1.6%); rom 8,824 (0.5%); ashkali 15,436 (0.9%); egjiptian 11,524 (0.7); goran 10,265(0.6%); të tjerë 2.352 (0.1%).



Sa i përket numrit të popullatës serbe në Kosovë konsiderohet të jetë më i lartë se sa paraqitet në statistikat zyrtare

Ndërkaq, sa i përket komuniteteve tjera joshumicë, siq janë: komuniteti ashkali, egjiptian, romë dhe goranë janë 2-3 (dy deri tri) herë më pakë të përfaqësuara me përqindjen e popullsisë së tyre në krahasim me numrin e përgjithshëm të banorëve.

**Tabela 6: Pasqyra e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në nivel të pushtetit komunal krahasuar me përqindjen e tyre në popullsinë e Kosovës.**



Në këto suaza, është shqetësuese mbetja anash e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve, egjiptian, ashkali, romë dhe goran, duke pasur parasysh faktin se me vite të tëra nuk është shënuar lëvizje apo përmirësim në këtë drejtim, Ndërkaq, Rregullorja nr. 04/2010, përcakton një numër të caktuar të masave pozitive të cilat institucionet duhet t'i ndërmarrin, qoftë në nivelin qendror apo atë lokal, me qëllim që të arrihet përfaqësimi i drejtë dhe proporcional i këtyre komuniteteve në shërbimin civilë.

**2. Shkalla e ulët e zbatimit të nenit 5, Rregullores nr.04/2010, mbi përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror, në “pozitat funksionale”.**

**2.1 Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në nivelin qendror**

MAP, për zbatimin e nenit 11 të LSHC, ka nxjerrë Rregulloren nr. 04/2010 për përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror. Për zbatimin e nenit 5 të Rregullores, parashihet që institucionet, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, të ndërmarrin veprime dhe masa aktive për punësim, me qëllim të përmirësimit në përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë. Është e nevojshme që komunat, përveç përmasave të përgjithshme për vendet e rezervuara, çdo institucion të përzgjedhë dhe të përmbushë kushtin prej 10%, dhe të zbatojnë së paku njërën nga 5 (pesë), prej kategorive të shënuara më poshtë, lidhur me punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në nivel qendror: 10% të zyrtarëve shtetërorë për katër kategori funksionale: zyrtarë shtetërorë në vende të larta udhëheqëse, zyrtarë shtetërorë në nivelet udhëheqëse, zyrtarë shtetërorë në nivelin profesional dhe zyrtarë shtetërorë të nivelit teknik – administrativ, në përputhje me nenin 23 të LSHC.

**2.2. Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në nivelin lokal**

Veprimet të cilat duhet zbatuar në nivelin lokal, përveç numrit të përgjithshëm të vendeve të rezervuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me përfaqësimin proporcional të komuniteteve në komunat përkatëse. Njëkohësisht, kërkohet që në përputhje me përqindjen e vendeve të punës, brenda kornizave funksionale të kategorive, të jenë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komunat përkatëse.

**3. Ofrimi i të dhënave të sakta lidhur me përkatësinë etnike të komuniteteve, të cilave i u përket kandidati, nga ana e institucioneve, si dhe fenomeni i të punësuarave të rrejshëm në pikëpamje të identitetit.**

Një numër shumë i vogël i institucioneve ka mbajtur evidencë lidhur me atë se cilit komunitet i takojnë kandidatët, prandaj ekziston edhe problemi i identitetit në përfaqësim të rrejshëm.

Të gjitha institucionet janë të detyruara të grumbullojnë të dhëna lidhur me aplikacionet për punë, sa i përket përkatësisë nacionale të komuniteteve dhe të punësuarave, me qëllim të përcjelljes dhe raportimit, por grumbullimi i të dhënave të tilla, gjer më tani, nuk ka qenë i mundur.

Gjatë një kohe, Grupi punues, i cili ka përcjellë zbatimin e kësaj rregullative ligjore, ka dërguar Pyetësorin në Ministrinë përkatëse, përmes të cilit janë kërkuar të dhëna statistikore lidhur me përkatësinë etnike të punësuarave, ashtu siç është parashikuar në nenet 8, 9 dhe 10 të Rregullores, në mënyrë që të arrihet te ato të dhëna në perspektivë.

Raporti i MAP mbi gjendjen në shërbimin shtetëror për vitin 2014, ka evidentuar ankesat në konkurse, si dhe procedurat në procesin e punësimit, por jo edhe sa i përket përkatësisë etnike të atyre që kanë ushtruar ankesa. Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2014, gjithashtu, nuk përmban të dhëna lidhur me atë se te kandidatët për punësim, nga pjesëtarët e pakicave, a është ushtruar ndonjë ankesë nga ana e tyre.

## **X. Përfundim**

Duke pasur parasysh gjetjet e grumbulluara, drejtimet me shkrim institucioneve, hulumtimet e realizuara parlamentare, numrin e dëgjimeve publike si dhe raportimet e ministrave dhe të autoriteteve tjera, GP ka arritur që të bëjë identifikimin e çështjeve të theksuara, si probleme për zbatimin e ligjit i cili rregullon fushën dhe problematikën e punësimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në bazë të problemeve të identifikuar, GP ka ardhur në përfundim se neni 11 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është i zbatueshëm me disa pengesa të caktuara, për të cilat duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes aktuale.

Me qëllim të ngritjes së nivelit për zbatimin e këtij ligji dhe të rritjes së përgjegjësisë institucionale, propozohen disa rekomandime.

## **IX. Rekomandime:**

1. Të implementohet në tërësi Neni 11, i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga të gjithë mekanizmat e implementimit të ligjit në të gjitha nivelet duke siguruar përfaqësim të drejtë dhe proporcional të të gjitha komunitetave jo shumicë në Kosovë në nivel qendror dhe lokal, ku secili institucion duhet të ndërmarr masa aktive dhe të veproj në përputhje me frymën e ligjit për gjithëpërfshirje dhe të ndërmirrën masa proactive të bazuara me rregullorën nr. 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
2. Që Qeveria, përkatësisht Ministria e Shërbimeve Publike, sa më parë të krijojë Bazën e të dhënave me numrin e të punësuarve, në mesin e tyre të dhëna të veçanta për strukturën etnike të punësuarve në Shërbimin Civil. Njëkohësisht, rekomandohet krijimi i sistemit elektronik për menagjimin e resurseve njerëzore, meqë dosjet elektorinke sigurojnë të dhënat reale të të punësuarve në rastin e deklarimit të përkatësisë etnike, si dhe procesi i rregullimit të shërbyesve civil, në Administratën Publike.

3. Të gjithë të punësuarit aktual në shërbimin civil të cilët janë të angazhuar mbi bazën e kuotës për komunitetet joshumicë në Kosovë dhe kandidatët të cilët aplikojnë në pozitat e nënpunësve civil në kuadër të kuotave për komunitetet joshumicë nga insititucioni përkatës, të vërfikohen dokumentet personale nga Enti i Statistikave të Kosovës në bazë të të dhënave këto të siguruara nga regjistrimi i fundit të popullsisë për vitin 2011, ku secilit i figuron deklarimi i përkatësisë etnike.
4. Të verifikohen të gjitha vendet e lira në administratën publike dhe të mirret qendrim që ato të rezervohen për plotësimin e vendeve nga komunitetet joshumicë, në radhë të pare të plotësohen me komunitetet e nënpërfaqësuar dhe të krjohen masa rekrutimi në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta dhe gjithpërfshirëse në Kosovë.

Bazuar në Hulumtim Parlamentar të KDI-së, të dhënat zyrtare dhe statistikat e prezentuara në raport, rezulton se komunitetet jo shumicë ashkali, romë egjiptina dhe goran, janë të nënpërfaqësuar në proporcion me numrin e polullsisë.

5. Të angazhohet Këshilli i Pamvarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vlersoj gjendjen e implementimit të Kushtetutës , Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative përperfaqësimin proporcional të komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës dhe të rekomandoj dhe obligoj masa shtesë për gjithëpërfshirje dhe përfaqësim proporcional në Administratën Publike për komunitet joshumicë në Kosovë.
6. Të krijohët një mekanizëm qendrorë unik i cili do të monitoroj ,propozoj dhe vendosë për ndërmarrjen e hapave konkret për krjimin e mekanizmve të cilët do të implementojnë me përpikmëri detyrimet ligjore të Qeverisë së Kosovës për përfaqësim të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës.
7. Të raportohet nga secili institucion qendror dhe local mbi baza të rregullta kohore të parapara me ligj dhe rregullore mbi ndërmarrjen e masave aktive dhe përmbushja e obligimit ligjorë për përfaqësim të komuniteteve jo shumicë dhe këto të dhëna të kenë qasje publike.
8. Që Qeveria e Republikës së Kosovës, në harmoni me kompetencat e veta , të nxjerr masa te veçanta dhe ti parasheh mjetet shtesë buxhetore për realizimin e kuotës minimale të punësimit të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë në Shërbimin civil, në nivelin qendror.

## **X. Materialet përcjellëse**

Dokumentet zyrtare:

- Pyetësi për MAP me pasqyrën e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në nivelin qendror dhe lokal në organet e administratës publike, agjencitë e pavarura dhe organet tjera të pushtetit ekzekutiv nga muaji mars 2015.
- Kërkesë për Zyrën juridike të Qeverisë për interpretimin ligjor të nenit 11.2 dhe 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për parimet ligjore të përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në organet e administratës publike.
- Hulumtimi parlamentar i KDI-së në temën: “Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në shërbimin shtetëror të Kosovës.

Arsyetimin për raport para Kuvendit, e prezenton raportuesi i Komisionit, **Veton Berisha**.

**Nënkryetari i Komisionit**

---

**Agim Çeku**